

Jusuf (Skënder) Kelmendi

(4.12.1975, shqiptar nga Peja/Peć, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Jusufi ka qenë i punësuar në shtypshkronjën *Dukagjini/Dukađini* në Pejë/Peć. Në datën 5.06.1998, ai aderoi në UÇK. Ishte i sistemuar në njësitin *Tigri/Tigar* në Glogjan/Glodane. Ka rënë në luftimet me forcat serbe më **10.08.1998**, në **Shaptej/Šaptelj**. Bashkëluftëtarët e kanë varrosur në varrezat e Irzniqit/Rznić. Pas lufte, mbetjet mortore të Jusufit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Pejë/Peć.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Yll (Avdullah) Morina

(11.08.1972, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, pedagog, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Ylli ka qenë student i Shkollës së Lartë Pedagogjike në Gjakovë/Đakovica. U largua nga vendi në vitet e nëntëdhjeta. Ka aderuar në UÇK më 12.04.1998. Së shpejti e kanë emëruar për komandant të një njësi. Në datën **10.08.1998**, e kanë plagosur rëndë në një betejë me forcat serbe në fshatin **Gramaçel/Gramočelj**. Bashkëluftëtarët e kanë çuar në spitalin e UÇK-së në Irzniq/Rznić. Me ndërmjetësimin e KNKK-së, e kanë transferuar në spitalin e Pejës/Peć, ndërkaq më vonë edhe në spitalin e Prishtinës/Priština, ku iu nënshtua disa intervenimeve kirurgjikale. Në fund, e kanë transferuar në spitalin e Novi Sadit, ku edhe ndërroi jetë më 15.03.1999. U varros në varrezat e Gjakovës/Đakovica, më 17.03.1999.

Burimet: deklarata V.S, FDH-12280; deklarata I.T, FDH-36483; B. Hamzaj, *Priča o ...*, 75; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; deklarata A.LI, FDH-36376.

Zenun (Mun) Mataj

(25.08.1975, shqiptar nga Baballoqi/Babalocë, komuna e Deçanit/Dečani, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Nexhat (Adem) Humaj

(20.09.1980, shqiptar nga Baballoqi/Babalocë,

komuna e Deçanit/Dečani, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Zenuni e kishte braktisur shkollën pas vdekjes së babait dhe ka shkuar në botën e jashtme për të punuar dhe financuar nënën dhe gjashtë vëllezër dhe motra. Në datën 20.04.1998, ai u kthye në Kosovë përmes Shqipërisë dhe menjëherë u inkuadrua në UÇK. Ato ditë [21.04.1998] edhe Nexhat Humaj u bë pjesëtar i UÇK-së në Baballoq/Babalocë.

Nexhati u vra, ndërkaq Zenuni u plagos rëndë më **11.08.1998**, gjatë luftimeve ndërmjet forcave të UÇK-së dhe atyre serbe në **Baballoq/Babalocë**. Pas përfundimit të betejës, bashkëluftëtarët e kishin bartur Zenunin në spitalin fushor të UÇK-së në fshatin Pagarushë/Pagaruša. Dy javë më vonë, më **25.08.1998**, Zenuni ka ndërruar jetë nga plagët e rënda. Nexhati dhe Zenuni tani prehen në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Baballoq/Babalocë.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Halil (Zymer) Sejfiqaj

(10.07.1933, shqiptar nga Glogjani/Glodane, komuna e Deçanit/Dečani, bujk, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Artan (Isa) Hasanaj

(2.06.1976, shqiptar nga Rakoci/Rakoc, komuna e Gjakovës/Đakovica, pjesëtar i UÇK-së)

Naim (Metë) Nimanaj

(6.05.1979, shqiptar nga Glogjani/Glodane, komuna e Deçanit/Dečani, pjesëtar i UÇK-së)

Halili, Artani dhe Naimi kanë qenë pjesëtarë UÇK-së. Artani ka jetuar me prindërit e tij në Zvicër deri në vitin 1998. Ata u strehuan atje për shkak të problemeve të vazhdueshme me pushtetin serb. Në datën 14.04.1998, Artani ka shkuar në Shqipëri, në bazën ushtarake *Golem* te Durrësit. Atje ai u inkuadrua në UÇK. U emërua komandant i njësitit të artilerisë në zonën operative të *Dukagjinit/Dukađini*. Naimi aderoi në UÇK më 24.03.1998. Ka shkuar dy herë për në Shqipëri për të sjellë armatime të reja për forcat e UÇK-së në Kosovë. Familja e Halilit u largua nga Glogjani/Glodane më 24.03.1998, por Halili ka mbetur për ta mbrojtur fshatin.